



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 411/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, Kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës Brahim Selimaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë, paraqitur kundër Rezultatit Përfundimtar të Publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga kandidati Brahim Selimaj për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, dega në Pejë.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014 në ora 12:50 ka pranuar një ankesë nga Brahim Selimaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, në të cilën ankesë pretendohet se nga të dhënat e siguruar në disa pika të vendotimeve (VV) si dhe në bazë të proceseve të vëzhguesve të bashkangjitura janë të dhënat: Në Qendrat e Votimit QV 1704/C/, 14D, 10R, 07R, 08R, 02R, 12R, 4R, 11R, 01R, 9R, në QV 1703/C, 01R, 02R, në QV 1702, 01R, 02R, 03R, 04R, 05R, në QV 1706, 07R, 08D, 03R dhe në QV 1704/068, 03R, 02R, 01R, 05R, 017R, 09R, 06R, 04R, ne QV 1705/07B, 05D, ne QV 170706R, 05R, 02R, 01R, 03R, në QV 1723C/01R, 07R, 08D, të vëzhguesit janë gjetur lista të manipuluar, forma të imponimit për kënd të votohet dhe të llogariten favore të caktuara.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur Formularët e Raportimit për Vëzhgues FRV.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat nga shkresat e lendes gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore të Brahim Selimaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së janë të pa bazuara, pasi që nuk mund të vërtetohen nga provat e paraqitura në ankesë. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë, ndërsa provat e propozuara nuk janë të pranueshme ngase nuk janë lëshuar nga KQZ-ja, kështu që ato prova nuk janë zyrtare. Meqë ankesa nuk bazohet në prova të sigurta, dyshimet për parregullsi me rastin e numërimit të votave për ankuesin nuk janë të argumentuara, për të cilën arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 411/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.